




Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamuša



01 Nr. 05/20
Me 27.05.2020
Mamushë

Në bazë të nenit 12 pika 12.2 alinea d dhe nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, sipas Ligjit 07/L-001 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020 dhe nenit 44.1 të Statutit të Komunës së Mamushës, të datës 01.12.2008, Kuvendi i Komunës së Mamushës bie këtë:

V E N D I M

Bartja e mjeteve të pa shpenzuara të të Hyrave Vetanake nga viti 2019 në vitin 2020

Neni 1

Aprovohet e kërkesa e Kryetarit të Komunës për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara të të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020 në shumën totale prej 44,015.73€ sipas kategorive ekonomike dhe nën programe buxhetore.

Neni 2

Në kategorin subvencione dhe transfere, shuma prej 24,000.00€

Në nën-programin Bujqësia (47014), kodi funksional (0421), shuma prej 24,000.00€.

Bartja e mjeteve në shumën prej 24,000€ në subvencione dhe transfere është për të ju ndihmuar fermerëve të Komunës së Mamushës me mjete bujqësore.

Neni 3

Në kategorin shpenzime kapitale, shuma prej 20,015.73€

Në nën-programin Infrastruktura Rrugore (18014), kodi funksional (0451), projekti "Riparimi dhe mirembajtja e rrugëve dhe kanaleve të hapura"- kodi i projektit (47115) në shumën prej 15,276.73€.

Në nën-programin Planifikimi i zhvillimit ekonomik (48014), kodi funksional (0411), projekti "Projekte për bashkefinansim me donator"- kodi i projektit (48840) në shumën prej 4,739.00 €.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë nga dita e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohet:

1. Zyra e Kryetarit të Komunës
2. Departamenti i Buxhetit Komunal – MFT
3. Arkiva

Kryesues i Kuvendit të Komunës

